



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 5886 prot.

Shkodër, me 14.4.2021

Lënda : Dërgohen mendimet e Ministrise se Financave dhe Ekonomise mbi raportin vjetor te monitorimit te buxhetit te vitit 2020

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Shkodër


Të nderuar këshilltarë

Bashkëlidhur po ju dërgojmë mendimet e Ministrise se Financave dhe Ekonomise mbi raportin vjetor te monitorimit te buxhetit te vitit 2020 te derguar me shkresen nr. 5825 date 30.03.2021.

Duke ju uruar punë të mbarë,

KRYETAR




Voltana ADEMI



DERGUAR NGA:

LENDA:

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Nr. 525 Prot

Tiranë, më 03/2021

Lënda: Dërgohen mendimet mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit 2020

BASHKISË Shkodër

KËSHILLIT TË QARKUT _____

Në zbatim të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, bashkëlidhur ju dërgojmë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit të vitit 2020.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



KOMENTE TË PËRGJITHSHME

“Raporti i Monitorimit i Bashkisë Shkodër për 12 mujorin e vitit 2020”

Monitorimi, është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Menaxhimi i shpenzimeve vendore është i rëndësishëm me qëllim realizimin e produkteve të parashikuara, brenda limitit të miratuar të shpenzimeve për çdo program. Nëpërmjet monitorimit të zbatimit të buxhetit është e rëndësishme që të sigurohet informacion i plotë në lidhje me performancën e shpenzimeve dhe realizimin e produkteve. Monitorimi i objektivave kryhet bazuar në treguesit përkatës të performancës që jepen kryesisht në nivel produkti, ndërsa monitorimi i produkteve realizohet në sasi dhe në vlerë. Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

1. Karakteristikat kryesore të shpenzimeve.

Bashkia Shkodër, për vitin 2020, administron dhe menaxhon fondet publike sipas programeve buxhetore të miratuara, në një total prej 28 programe, e më konkretisht:

1. Planifikim, Menaxhim Administrim
2. Gjendja Civile
3. Shërbimet e policisë vendore
4. Mbrojtja nga zjarri dhe Mbrojtja Civile
5. Mbështetja për zhvillimin ekonomik
6. Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi
7. Shërbimet bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve
8. Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit
9. Administrimi i pyjeve dhe kullotave
10. Rrjeti rrugor rural
11. Transporti publik
12. Zhvillimi i turizmit
13. Menaxhimi i mbetjeve
14. Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve
15. Programet e mbrojtjes së mjedisit
16. Ndërgjegjësimi mjedisor
17. Planifikimi urban vendor
18. Shërbimet publike vendore
19. Ndricim rrugësh
20. Shërbimet e kujdesit parësor
21. Sport dhe argëtim
22. Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
23. Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
24. Arsimi i mesëm i përgjithshëm
25. Arsimi profesional
26. Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara
27. Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

28. Strehimi Social

Konstatohet se për bashkinë Shkodër burim kryesor i financimit për buxhetin e vitit 2020 janë të ardhurat nga burimet e veta dhe pjesa tjetër nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme, specifike, dhe transfertat e kushtëzuara. Mbështetur mbi programet e mësipërme, Bashkia Shkodër ka organizuar ndarjen e shpenzimeve buxhetore me qëllim financimin e plotë të të gjitha kompetencave dhe shërbimeve ndaj qytetarëve që ofron kjo NJVQV. Në raportin e paraqitur është arritur zhvillimi i një analize të përgjithshme të realizimit të buxhetit 2020 dhe gjithashtu një analizë të detajuar në nivel objektiv dhe financimi sipas llogarive ekonomike.

TË ARDHURAT

Analiza e realizimit të të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër duhet të zërë një pjesë të rëndësishme të raportit të monitorimit. Bashkia Shkodër ka paraqitur një pasqyrë të detajuar të planit të të ardhurave sipas burimit dhe nivelit të realizimit për secilin zë. Nga ky raport kuptohet që kjo bashki për vitin 2020 ka patur një plan të të ardhurave të veta prej rreth 795.759 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 659.020 mijë lekë ose 82.8% të planit vjetor. Nga analiza konstatohet që peshën më të madhe në vlerë të të ardhurave të bashkisë e zë taksa mbi pasurinë, ndjekur nga tarifa për shërbimet publike apo të ardhura të tjera jotatimore të cilat ndihmojnë në financimin e shërbimeve që ofron kjo bashki. Nga analiza e raportit të monitorimit vërehet një disbalancë midis faktit dhe planit për taksat vendore, realizueshmëria e të cilave është vetëm 58.9%, për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, e cila është realizuar në masën 38% , taksa mbi tokën bujqësore realizuar në masën 22%. Ndërkohë të ardhurat nga tarifatat vendore paraqiten me një realizim në masën 95 %. Një ndër faktorët kryesorë i cili ka ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave vendore për vitin 2020, ka qënë situata e vështirë e krijuar nga pandemia Covid-19. Bashkia Shkodër duhet të synojë që raporti i planit të të ardhurave me realizimin faktik të jetë sa më realist duke arritur në këtë mënyrë mbledhjen e një niveli të lartë afër kapacitetit fiskal që disponon. Bashkia Shkodër duhet që domosdoshmërisht të përmirësojë jo vetëm raportin e të ardhurave të veta ndaj të ardhurave të përgjithshme por gjithashtu edhe nivelin e mbledhshmërisë së të ardhurave. Një raport i ulët i realizimit të të ardhurave të veta do të jetë një shkak i rëndësishëm për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe uljen e efekshmërisë së menaxhimit të financave publike. Vlerësojmë analizën e paraqitur nga bashkia Shkodër për pjesën e të ardhurave sipas taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020, duke pasqyruar dhe faktorët pozitivë dhe negativë që kanë ndikuar në realizimin ose jo të tyre gjatë vitit buxhetor.

SHPENZIMET

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Bashkia Shkodër mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2020, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë bashki paraqitet si më poshtë:

<i>Në mijë lekë</i>				
	Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	% e realizimit
1	Shpenzime Personeli (600+601)	813,510	636,863	78%
2	Shpenzime Operative (602-606)	875,671	731,475	84%

Ministria e Financave dhe Ekonomisë / Drejtoria e Financave Vendore

3 Shpenzime Kapitale (230-231)	769,184	701,216	91%
TOTALI	2,458,365	2,069,554	84%

Sikurse mund të konstatohet nga tabela e mësipërme, masa e realizimit vjetor të buxhetit të vitit 2020, kundrejt planit të buxhetit vjetor të rishikuar është 84 % (pa përfshirë pjesën e transfertës së kushtëzuar). Realizimi i shpenzimeve personelit ka arritur në një nivel prej rreth 78 %, realizimi i shpenzimeve operative në masën 84%, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve kapitale paraqitet në një nivel prej 91%, të planit vjetor. Në tërësi sugjerohet rritja e nivelit të realizimit vjetor të shpenzimeve buxhetore, duke vënë një fokus të rëndësishëm kryesisht në realizimin e plotë të shpenzimeve për investime të cilat kanë një efekt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, ndërkohë që bashkia Shkodër ka arritur një nivel shumë të lartë të realizimit të investimeve për vitin 2020. Nga analiza e raportit, konstatohet se pesha që zënë shpenzimet e personelit tek totali është rreth 31%, shpenzimet operative 35% ndërsa shpenzimet kapitale zënë vetëm 34% të shpenzimeve totale.

Ndarja e fondeve buxhetore sipas programeve, dhe realizimi i shpenzimeve për çdo program buxhetor, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Emërtimi i Programit	Shpenzimet 2020		% e realizimit ne total
	PLAN	FAKT	
Planifikim, Menaxhim Administrim	336,200	245,534	73%
Shërbimi i gjendjes civile	22,337	17,091	77%
Shërbimet e policisë vendore	31,909	22,211	70%
Mbrojtja nga zjarri dhe Mbrojtja Civile	124,993	48,878	39%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	9,605	5,114	53%
Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	1,500	144	10%
Shërbimet bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	2,444	1,014	41%
Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	54,160	29,862	55%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	30,637	11,821	39%
Transporti rrugor/Mirëmbajtje rrugë rurale	506,699	302,020	60%
Menaxhimi i rrugëve	167	86	51%
Transporti publik	20,905	4,450	21%
Zhvillimi i turizmit	6,950	2,624	38%
Menaxhimi i mbetjeve	235,949	131,593	56%
Menaxhimi i ujërave të zeza	19,098	14,710	77%
Urbanistikë vendore	2,168	0	0%
Strehimi	74,666	69,144	93%
Shërbimet publike vendore	96,586	78,943	82%
Ujësjiellës kanalizime vendore	48,489	18,585	38%

Ministria e Financave dhe Ekonomisë / Drejtoria e Financave Vendore

Ndricimi i rrugëve	110,894	106,644	96%
Shërbimet e kujdesit parësor	4,500	1,147	25%
Sport dhe argëtim	130,322	104,715	80%
Zhvillimi i sportit	3,573	3,229	90%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	111,232	71,887	65%
Arsimi parashkollor dhe 9-vjeçar	323,378	260,478	81%
Arsimi parauniversitar	149,977	111,788	75%
Arsimi profesional	28,949	11,299	39%
TOTALI	2,488,287	1,675,011	67%

Sipas të dhënave për realizimin e shpenzimeve për vitin 2020, në nivel programi evidentohet se. Programet “Srehimi”, “Shërbimet publike vendore”, “Ndriçim rrugësh” “Sport dhe argëtim”, “Zhvillimi i sportit” “Arsimi parashkollor dhe 9-vjeçar”, kanë një realizim shumë të mirë të buxhetit me mbi 80%, ndërkohë që programet të cilat paraqiten me një realizim të ulët krahasuar me buxhetin e planifikuar janë “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” (39%), “Transporti publik” (21%), “Arsimi profesional” (39%). Në total rezulton se performanca e realizimit të shpenzimeve për 12-mujorin e vitit 2020 (pa përfshirë shpenzimet e financuara nga transfertat e kushtëzuara), është në masën 67 për qind krahasuar me planin vjetor të miratuar. Konstatohet se realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me një vit më parë ka një ulje, e cila argumentohet nga bashkia Shkodër për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Kjo situatë është shoqëruar me mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifrat vendore, mos realizim i disa projekteve në programe të ndryshme, si dhe mos realizim i disa projektsh investimesh.

Në përgjithësi konstatohet që ato programe që kanë peshë më të vogël në shpenzimet vendore kanë edhe realizim të lartë. Mosrealizimi i shpenzimeve nga Bashkia Shkodër për disa programe sjell një efekt negativ në kthimin që do të sigurohej nga përdorimi i këtyre parave. Buxheti i pa realizuar mund të alokohej në programe të tjera të cilat mund të kenë nevojë për financim por gjithashtu rrisin cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Peshën më të madhe të buxhetit të bashkisë e zënë programet: “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, “Transporti rrugor”, “Arsimi parashkollor dhe 9-vjeçar”, programe të cilat lidhen drejtpërdrejt me shërbimet ndaj qytetarëve.

Nga analiza e raportit të monitorimit të Bashkisë Shkodër duhet vlerësuar zhvillimi pozitiv i buxhetimit deri në nivel produkti. Bashkia në raportin e monitorimit të paraqitur ka detajuar produktet e realizuara për secilin program buxhetor, duke lehtësuar në këtë mënyrë lidhjen e secilit program me produktet. Në këtë drejtim sugjerojmë që Bashkia Shkodër të monitorojë realizimin e produkteve buxhetore në përputhje të plotë me planifikimin buxhetor afatmesëm.

Një pjesë e rëndësishme në raportin e monitorimit është paraqitja e masave që janë ndërmarrë gjatë vitit buxhetor në rishikimin e planit si p.sh: transferim fondesh ndërmjet programeve buxhetore, rishpërndarje fondesh ndërmjet zërave të shpenzimeve korrent. Bashkia Shkodër në

raportin vjetor ka paraqitur informacionin të cilit i është referuar rishikimit të buxhetit gjatë vitit 2020.

2. Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

Në raportin e monitorimit është e rëndësishme të paraqitet raporti i objektivave të synuar dhe treguesit e performancës për çdo program. Kjo për të evidentuar produktet dhe më pas të shkojmë drejt objektivit kryesor kostimin e tyre. Vlerësojmë punën e bërë për vitin 2020 nga Bashkia Shkodër në paraqitjen paraqitur objektivave dhe treguesve të performancës për çdo program buxhetor nëpërmjet të cilave përmbushet vizioni dhe strategjia e zhvillimit të bashkisë.

3. Projektet e Investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj

Bashkia Shkodër ka paraqitur një informacion të detajuar mbi realizimin e projekteve të investimeve për vitin 2020, me burim financimi burimet e veta, transfertën e pakushtëzuar dhe donacione të ndryshme. Gjatë vitit 2020 bashkia Shkodër ka mbështetur disa projekte në vazhdim investimesh, projektet të cilat kanë një rëndësi të ndjeshme për zhvillimin e territorit të bashkisë. Nga analiza në nivel llogarie ekonomike, investimet kanë një nivel të realizimit me 91 %, duke paraqitur një nivel të vlerësuar realizimi. Nga raporti vërehet që në vitin 2020 disa prej projekteve të planifikuara janë paraqitur të përfunduara, ndërkohë që janë financuar edhe investimet në proces. Në raport paraqiten me realizim 0% projekte të financura nga ish-komunat të cilat kanë dokumentacion financiar dhe ligjor jo të rregullt.

Projektet kryesore të investimeve janë përqëndur kryesisht në rikonstruksionin dhe asfaltimin e rrugëve, rikualifikim urban të blloqeve të banimit, investime në ndriçimin e rrugëve. Ndër projektet kryesore për vitin 2020 mund të përmendim:

- Zgjerimi i rrjetit të ujësjellës kanalizime i rrugës Zef Karriqi
- Rikonstruksion rrugët e brendshme Shirokë
- Rikualifikim urban blloqe banimi "Bulevardi Zogu i parë"
- Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Mehmet Pashë Plaku"

Bashkia Shkodër ka paraqitur edhe argumentat lidhur me shkaqet e mosrealizimit të projekteve përkatëse të investimeve sipas programeve buxhetore.

4. Treguesit financiarë 2020

Për pjesën e treguesve financiarë të paraqitur në shtojcën 5 të udhëzimit standart nr.22 datë 30.07.2018 "Për procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", nuk mund të shprehemi, përse kohë nuk janë paraqitur në raport nga njësia vendore.

5. Detyrimet e prapambetura

Bashkia Shkodër ka paraqitur një informacion të detajuar lidhur me detyrimet e prapambetura për vitin 2020. Detyrimi i mbetur në fund të vitit 2020 është në vlerë prej 3,199 mijë lekë, i cili është likuiduar në fillim të vitit 2021.

6. Komentete të tjera dhe rekomandime

- Raporti i monitorimit të Bashkisë Shkodër është paraqitur në kohë në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr.22 datë 30.07.2018 “Për procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- Raporti i monitorimit për 12-mujorin e vitit 2020 është i shoqëruar me anekset përkatëse të plotësuara në përputhje me udhëzimin e sipërcituar.
- Vlerësojmë raportin e monitorimit të paraqitur nga bashkia Shkodër. Në përgjithësi ky raport ka paraqitur një informacion të detajuar mbi procesin e monitorimit, ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave për çdo program.
- Duke vlerësuar përpjekjet e Bashkia Shkodër, sjellim në vëmendje që raporti i monitorimit të paraqitur ka një informacion të rëndësishëm mbi bazë programi dhe produkti. Në këtë drejtim procedurat e menaxhimit mbi bazë produkti janë një hap i drejtë i bashkisë Shkodër për menaxhimin mbi bazë performance.
- Emërtimi i programeve në anekset e raportit të monitorimit dhe në relacionin shpjegues duhet të jetë në përputhje me listën e programeve të miratuara me aktet ligjore në fuqi. Si rrjedhojë, sygjerojmë që monitorimi i shpenzimeve për trasfertat e kushtëzuara nga buxheti i shtetit për bashkinë Shkodër të realizohet më vete për vetë specifikën që kanë këto fonde.
- Analiza e monitorimit të buxhetit 2020 është zhvilluar në nivel produkti buxhetor, duke lehtësuar në këtë mënyrë identifikimin e punëve publike të mbështetura me këtë buxhet dhe mundësuar zbatimin e plotë të standarteve të udhëzimit.
- Sygjerojmë, të evidentohet qartë lidhja ndërmjet programit buxhetor afatmesëm të Bashkisë Shkodër dhe produkteve të realizuara gjatë zbatimit të buxhetit. Kjo me qëllim unifikimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit vendor.
- Bashkia Shkodër duhet të vazhdojë të ketë prioritet moskrijimin e detyrimeve të reja dhe planifikimin për shlyerjen e detyrimeve të trashëguara nga vitet parardhëse.
- Raporti i monitorimit duhet të publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë Shkodër, në kuadrin e transparencës të realizohet publikimi i raportit të monitorimit të buxhetit vjetor me qëllim që të jetë i aksesueshëm nga të gjitha grupet e interesit.